



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 77, Datë 19/03/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 149, datë 13.11.2017, e Znj. F. Sh., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “predispozicionit gjenetik”, nga ana e Drejtorisë Rajonale të OSHEE Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, ankuesja dhe bashkëshorti i saj, R. Sh., janë të papunë dhe familja e tyre është përfituese e ndihmës ekonomike. Znj. F. Sh. thekson faktin se djali i tyre është tetraplegjik¹ (invalid i grupit të parë) dhe gjendja ekonomike e familjes së tyre është e tepër e vështirë². Ajo vë në dukje faktin se faturimi i OSHEE Shkodër për muajin

¹ Referuar librezës nr. 081018, datë 01.06.2016, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

² Referuar vërtetimit nr. 20980, datë 20.11.2017, të Bashkisë Shkodër.

prill dhe korrik 2017 ka qenë tepër i lartë, krahasuar me muajt e tjerë. Për këtë arsye, ankuesja ka paraqitur ankesë pranë OSHEE Shkodër, por nuk i ka ardhur asnjë përgjigje zyrtare nga ky institucion. Njëkohësisht, Znj. F. Sh. thekson faktin që familja e saj ndodhet në cilësinë e debitorit ndaj OSHEE-së dhe prej disa kohësh paguan një këst mujor prej 1000 lekësh. Duke qenë se familja e saj ndodhet në gjendje të vështirë ekonomike, ankuesja kërkon ndërhyrjen e Komisionerit, për uljen e vlerës së këtij kësti mujor.

“Aftësia e kufizuar” dhe “predispozicioni gjenetik ” janë dy prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

✚ Njëpërmjet shkresës nr. 1112/1 Prot., datë 22.11.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, njoftoi të Drejtorinë Rajonale të OSHEE Shkodër, mbi ankesën e mësipërme, si dhe kërkoi informacion mbi çështjen e parashtruar nga ankuesja.

- Drejtoria Rajonale e OSHEE Shkodër nuk i dërgoi përgjigje shkresës së Komisionerit.

✚ Në vijim të procedurave hetimore, në zbatim të Urdhërit nr. 3, datë 09.01.2017, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u krye inspektim pranë Drejtorisë Rajonale të OSHEE Shkodër.

Nga informacioni i administruar gjatë inspektimit rezultoi se Znj. F. Sh. kishte depozituar 2 ankesa, lidhur me faturimin e kryer nga OSHEE Shkodër, për muajt prill dhe korrik 2017. Drejtoria Rajonale e OSHEE Shkodër i ka kthyer përgjigje ankueses, njëpërmjet shkresës nr. 57, datë 11.01.2018, ku familja e F. Sh. informohet, se pas verifikimeve të kryera nga strukturat përgjegjëse të OSHEE-së Shkodër rezultonte se kilovatwt (kwh) e konsumuar, janë regjistruar në aparatën e matësit të kësaj familje, pra sasia e shpenzuar nga kjo familje ishte e njëjtë me atë të faturuar. Inspektorët e Komisionerit morën sqarimet përkatëse lidhur me çështjen e faturimit për muajt prill dhe korrik 2017 nga ana e familjes së F. Sh., si dhe morën në cilësinë e provës, akte të ndryshme për interes të çështjes në shqyrtim.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Familja e F. Sh. është ankimuar pranë OSHEE Shkodër, për faturimin e kryer nga strukturat përgjegjëse të këtij institucioni, për muajt prill dhe korrik 2017. Nëpërmjet shkresës nr. 57, datë 11.01.2018, Drejtoria Rajonale e OSHEE Shkodër e informon familjen e F.SH. se: *“Struktura e sektorit të lexim-matjes në bashkëpunim me Qendrën KnK që mbulon zonën tuaj, bëri verifikimin e objektit i cili korrespondon kontratës nr. SH2A020051000001. Sipas procesverbalit të mbajtur në terren me datë 04/01/2018, rezultoi se objekti është me matës dhe brenda kushteve teknike. Për sa i përket faturimit të muajve Prill, Korrik 2017, fatura të ankimuar nga ana juaj, ankesa juaj nuk qendron pasi në bazë të raportimeve: kWh e konsumuar janë rregjistruar në aparatit e matësit tuaj.....”*.

Mbështetur në verifikimet e kryera nga Komisioneri, pranë Drejtorisë Rajonale të OSHEE Shkodër, si dhe duke iu referuar faturave mujore të lëshuara nga ky institucion, për energjinë elektrike të konsumuar nga familja e F. Sh., rezulton se kjo familje është faturuar për 1826 kWh energji elektrike për muajin prill 2017. Shuma korresponduese për këtë faturim është 20,816 lekë. Nëse i referohemi faturave të 2 muajve paraardhës rezulton se këta muaj nuk janë të evidentuar/faturuar. Në këtë kontekst, faturimi i muajit prill 2017 ka përfshirë edhe faturimet e muajve shkurt-mars 2017. Mos faturimi për muajt shkurt – mars 2017 mund të ketë ndodhur, pasi, për arsye të ndryshme, faturuesi i OSHEE Shkodër nuk ka patur dot akses³ në aparatit matës të familjes së F. Sh. Kështu që faturimi për energjinë elektrike të muajit prill 2017, për familjen e F. Sh. mbart edhe konsumin e energjisë elektrike për muajt paraardhës, të cilët janë të pafaturuar.

Faturimi i energjisë elektrike së konsumuar nga kjo familje për muajin korrik 2017 është 713 Kwh, që i përket shuma korresponduese 8,128 lekë. Nëse do t’i referoheshim faturës së muajit qershor 2017, rezulton se faturimi për këtë muaj ka qenë 77 kwh ose 800 lekë. Faturimi për muajin korrik ka mbartur edhe faturimin për muajin qershor 2017.

2. Njëkohësisht, kjo familje e cila ndodhet në cilësinë e debitorit ndaj OSHEE Shkodër, paguan çdo muaj 1000 lekë për shlyerjen e debisë së saj.

³ Përfaqësuesit e OSHEE Shkodër sqaruan se shpeshherë faturuesit e këtij institucioni nuk kanë akses tek aparatet e matjes së energjisë elektrike, në familje të ndryshme, pasi në banesat e qytetarëve nuk gjendet njeri që t’ju mundësojë akses në to.

Familja e F. Sh. është debitore ndaj Drejtorisë Rajonale të OSHEE SHkodër që prej vitit 2014, vit në të cilin kjo familje ka lidhur Akt-marrëveshje me këtë institucion për të paguar debinë e saj, për periudhën dhjetor 2009-nëntor 2015. Në bazë të verifikime të kryera në sistemin on line të OSHEE Shkodër, rezulton se familja F.Sh ka paguar 38 këste të kësaj debie. Aktualisht, kjo familje është debitore ndaj OSHEE Shkodër, në shumën 172.908,51 lekë. Nga verifikimet e kryera rezulton se ankuesja ka qenë e rregullt në pagesat e kryera për shlyerjen e debisë së saj. Vlera e kësti mujor, që ajo paguan është 1000 lekë, pasi kjo familje përfiton nga skemat lehtësuese të OSHEE-së, pasi është familje që trajtohet me ndihmë ekonomike, si dhe ka në përbërjen e saj një person me aftësi të kufizuar. Referuar Vendimit të Keshillit Mbikqyrës të OSHEE, datë 26.11.2014 (i ndryshuar) rezulton se kësti në vlerë normale për shlyerjen e energjisë elektrike ndaj OSHEE-së kap vlerën 2500 lekë/muaj, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, vlera e këtij kësti mujor është 1200 lekë, ndërkohë që për familjet që kanë në përbërje të tyre persona me aftësi të kufizuara, kësti mujor është 1000 lekë/muaj. Aktualisht, familja e F. Sh. paguan vlerën më të ulët të këstit mujor për shlyerjen e debisë ndaj OSHEE Shkodër.

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri gjykon se familja e F. Sh. nuk i është nënshtruar apo është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Drejtorisë Rajonale të OSHEE Shkodër.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, Komisioneri gjykon se nuk ndodhemi para një situatë diskriminuese për familjen F.Sh.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “predispozicionit gjenetik”, të Znj. F. Sh., nga ana e Drejtorisë Rajonale të OSHEE Shkodër.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 45 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Irma BARAKU
KOMISIONERI

(Shkak: aftësia e kufizuar dhe predispozicionit gjenetik
Fusha: Të mira dhe shërbime)